

	Regjistrimi dhe Çregjistrimi i Sistemit Matës	PR-MO-003
	<i>ver. 1.0</i>	<i>page 1 from 23</i>
<i>Departamenti: Operimi i tregut</i>		<i>Sektori: Menaxhimi i Kodit</i>

Regjistrimi dhe Çregjistrimi i Sistemit Matës

	Regjistrimi dhe Çregjistrimi i Sistemit Matës	PR-MO-003
	ver. 1.0	page 2 from 23
Departamenti: Operimi i tregut		Sektori: Menaxhimi i Kodit

PËRMBAJTA

1.QËLLIMI	3
2.FUSHA	3
3 . PALËT PËRGJEGJËSE	4
3.1 Operatori i Tregut.....	4
3.2 Operatori i Sistemit.....	4
3.3 Pjesëmarrësit e Tregut	4
4. PËRMBLEDHJE	5
4.1 Regjistrimi Fillestar i Sistemeve të Matjes për 1 Korrik 2007	5
4.2 Regjistrimi i Sistemeve Matëse	5
4.3 Çregjistrimi i Sistemeve Matëse.....	7
4.4 Çregjistrimi i Sistemeve Matëse pas Anulimit të një Pjesëmarrësi të Tregut.....	8
4.5 Ndryshimi i të dhënave Teknike dhe Ndryshimi i të dhënave të Furnizuesit për Sistemet Matëse të Regjistruara.....	9
5. PËRMBLEDHJA E PROCEDURËS	10
5.1 Dispozitat e Përgjithshme	10
5.2 Regjistrimi Fillestar i Sistemeve Matëse më 1 korrik 2007	11
5.3 Regjistrimi i Sistemeve Matëse	11
5.4 Çregjistrimi i Sistemeve Matëse.....	13
5.5 Çregjistrimi i Sistemeve të Matjes pas Anulimit të një Pjesëmarrësi të Tregut.....	14
5.6 Ndryshimi i të Dhënave Teknike të Sistemeve Matëse të Regjistruara	15
5.7 Ndryshimi i të Dhënave të Furnizuesit të Sistemeve Matëse të Regjistruara (ndërrimi i konsumatorit)	16
6.ANEKSET	17
Aneksi 1: Forma e Regjistrimit dhe Çregjistrimit të Sistemit Matës (ju lutem shihni faqen vijuese për një shembull)	17
Aneksi 2: Lista Kontrolluese për Regjistrimin e Sistemit Matës dhe Struktura e MS Bazës së të Dhënave	19
Aneksi 3: Skema e ETSO për Identifikimin e Pikës Matëse.....	22
7. DOKUMENTET/FORMULARËT	23

	Regjistrimi dhe Çregjistrimi i Sistemit Matës	PR-MO-003
	ver. 1.0	page 3 from 23
Departamenti: Operimi i tregut		Sektori: Menaxhimi i Kodit

1. QËLLIMI

Kjo Procedurë Operative definon kërkesat, planet kohore dhe përgjegjësitë për Regjistrimin e Njehsorëve dhe kërkesat për regjistrimin e çfarëdo ndryshimi në Sistemet Matëse tashmë të regjistruara nga Operatori i Tregut (OT). Prandaj kjo procedurë ka për qëllim të përmbush përgjegjësitë e OT për të siguruar barazimin e duhur të energjisë.

Kjo procedurë duhet të lexohet në lidhje me Rregullat e Tregut (RrT) të Kosovës (Kapitulli V) të kërkesave të Kodit të Matjes për Tregun e Energjisë në Kosovë.

Kjo procedurë aplikohet për pjesëmarrësit e tregut duke vepruar si Palë Tregtare ose cilindo pjesëmarrës si definohet në Nenin 10 të RrT.

Termet Specifike të përdorura në këtë procedurë janë të definuara në një dokument të veçantë “Fjalorthi i Procedurave Operative” i cili do të dorëzohet dhe publikohet së bashku me Procedurat. Termet të cilat tashmë janë të definuara në Rregullat e Tregut, Kodin e Rrjetit dhe Kodin e Matjes nuk do të definohen në Fjalorthin e Procedurave Operative.


2. FUSHA

Kjo Procedurë Operative ofron definicionet për Regjistrimin dhe Çregjistrimin e Sistemeve Matëse. Kjo siguron që asnjë Sistem Matës të mos jetë i pa llogaritur në procesin e barazimit. Kjo procedurë gjithashtu përcakton dispozitat për regjistrimin e sistemeve matëse për të gjithë Pjesëmarrësit ku Operatori i Sistemit (OS) mbledh të dhënat në mënyrë që të mbështes OT të përmbush detyrat si agjent faturues si definohet në RrT në fuqi.

Kjo mbulon:

- Sistemet Matëse të Gjeneratorëve,
- Sistemet Matëse të Interkonekcionit,
- Sistemet Matëse që shënojnë kërkesën nga konsumatorët e kualifikuar të lidhur drejtpërdrejt në Sistemin e Transmisionit,
- Sistemet Matëse të ndërlidhura Pikat e Kyçjes të Sistemeve Transmision-Shpërndarje dhe Centralet Gjeneruese të ndërlidhura si dhe konsumatorët e kualifikuar të lidhur me rrjetin shpërndarës, përkatësisht nënshkruesit e Marrëveshjes Kornizë të Rregullave të Tregut.

Kjo procedurë nuk mbulon asnjë veprim për marrjen e të dhënave të matjes dhe agregimin e të dhënave, gjë që duhet të bëhet nga OS në mënyrë që të mbështet OT në përmbushjen e detyrave si agjent faturues. Ju lutem referohuni procedurës T101 për këtë qëllim.

	Regjistrimi dhe Çregjistrimi i Sistemit Matës	PR-MO-003
	ver. 1.0	page 4 from 23
Departamenti: Operimi i tregut		Sektori: Menaxhimi i Kodit

3 . PALËT PËRGJEGJËSE

3.1 Operatori i Tregut


- Përgatitë këtë procedurë operative dhe zbaton atë.
- Përmirëson dhe azhurnon këtë procedurë varësisht nga ndryshimet e legjislacionit primar dhe sekondar në fushën e energjisë.
- Publikon Sistemet e Matjes të regjistruara me sukses si dhe çregjistrimin e Sistemeve Matëse.
- Ofron dhe pranon listat kontrolluese për regjistrimin dhe çregjistrimin e Sistemeve të Matjes.
- Themelon dhe mirëmban Regjistrin e Matjes.
- Pranon, shënon dhe analizon aplikacionet për regjistrimin e Sistemeve Matëse.
- Pranon, shënon dhe analizon aplikacionet për çregjistrimin e Sistemeve Matëse (ose përkatësisht njoftimin për anulim).
- Ofron konfirmimin/refuzimin e aplikacionit për regjistrimin e Sistemit Matës dhe çregjistrimin e Pjesëmarrësit të Tregut.
- Njofton OS për regjistrimin e suksesshëm, çregjistrimin e Sistemeve Matëse dhe çfarëdo ndryshimi në regjistrimin e Sistemeve Matëse.

3.2 Operatori i Sistemit

- Ofron dhe pranon listat kontrolluese për të dhënat teknike për Sistemin Matës sipas dispozitave dhe kërkesave të kësaj procedure operative.

3.3 Pjesëmarrësit e Tregut

- Aplikojnë për regjistrim dhe dorëzojnë të gjitha të dhënat e nevojshme për regjistrim nga OT.
- Aplikojnë për çregjistrim dhe dorëzojnë të gjitha të dhënat e nevojshme OT.
- Dorëzojnë të gjitha të dhënat e nevojshme teknike të kërkuara nga OS për qëllim të Mbledhjes së të Dhënave të Matjes.

	Regjistrimi dhe Çregjistrimi i Sistemit Matës	PR-MO-003
	<i>ver. 1.0</i>	<i>page 5 from 23</i>
<i>Departamenti: Operimi i tregut</i>		<i>Sektori: Menaxhimi i Kodit</i>

4. PËRMBLEDHJE

4.1 Regjistrimi Fillestar i Sistemeve të Matjes për 1 Korrik 2007

Ky kapitull ofron informata se si duhet të kryhet regjistrimi fillestar i Sistemeve Matëse nga OT në mënyrë që të sigurohet se të gjitha të dhënat e nevojshme për barazim gjatë periudhës tranzitore të Fazës 1 janë të gatshme deri me 1 korrik 2007. Të dhënat e pranuar gjatë regjistrimit fillestar do të përdorin bazën fillestare të të Dhënave, e cila është e themeluar dhe operohet nga OS. Për shkak të natyrës tranzitore të kësaj detyre, veprimet janë të dizajnuara më thjeshtë në krahasim me kërkesat për regjistrimin e Sistemit Matës (SM) si një nga detyrat e rregullta të Operatorit të Tregut

4.2 Regjistrimi i Sistemeve Matëse

Ky kapitull ofron informata se cilët hapa të regjistrimit Pjesëmarrësit e Tregut duhet të ndërmarrin gjatë procesit të regjistrimit të Sistemeve Matëse.

Vërejtje: Ky seksion duhet të lexohet së bashku me kërkesat përkatëse për regjistrimin e Pjesëmarrësve të Tregut dhe roleve në Tregun e Energjisë Elektrike në Kosovë dhe në lidhje me procedurën operative ET001.

Bazuar në dispozitat e RrT Kapitulli V, ky kapitull definon

1. Cilët hapa duhet të ndërmerren nga Pjesëmarrësit për Regjistrimin e Sistemeve Matëse.
2. Cilat shkëmbime të të dhënave ndërmjet Pjesëmarrësit të Tregut i cili aplikon dhe OT janë të nevojshme në mënyrë që të regjistrohet si duhet sistemi matës



	Regjistrimi dhe Çregjistrimi i Sistemit Matës	PR-MO-003
	ver. 1.0	page 6 from 23
Departamenti: Operimi i tregut		Sektori: Menaxhimi i Kodit

Tabela vijuese ofron një përmbledhje:

Veprimet /Dokumentet	Pala Aplikuese D- Dërgon P-Pranon	OT D- Dërgon P-Pranon	OS D- Dërgon P-Pranon	Plani kohor Së paku X ditë pune deri në Datën Efektive
Dorëzon formën e regjistrimit përfshirë autorizimet e nevojshme	D	P		40
Kontrollon formën e regjistrimit dhe njofton Operatorin e Sistemit		D	P	35
Dërgon listën kontrolluese të regjistrimit të Sistemit Matës (detajet teknike) ¹	P		D	25
Dorëzon listën kontrolluese për regjistrim të plotësuar si duhet	D		P	20
Lista kontrolluese e vlefshmërisë së Regjistrimit: Miraton ose Refuzon aplikacionin për shkak të mos kompletimit të listës kontrolluese – prapa te “Dorëzimi i listës kontrolluese të plotësuar si duhet	P	P	D	15
Regjistrimi i Sistemit Matës	P	D	P	2, 10 pd
Konfirmimi i aktivizimit të suksesshëm/Energjizimi i Sistemit Matës	P	P	D	1; 12 pd
Publikimi i Regjistrimit të Sistemit Matës në Faqen Elektronike		D		D+1

¹ Për Sistemet e Matjes të Ndërlidhura psh. njësorët e instaluar në Njësitë Gjeneruese të Ndërlidhura, Lista Kontrolluese për Regjistrimin e Sistemeve Matëse do t'i dërgohet Operatorit të Sistemit të Distribucionit.

	Regjistrimi dhe Çregjistrimi i Sistemit Matës	PR-MO-003
	ver. 1.0	page 7 from 23
Departamenti: Operimi i tregut		Sektori: Menaxhimi i Kodit

4.3 Çregjistrimi i Sistemeve Matëse


Në bazë të dispozitave të RrT ky kapitull definon,

1. Cilët hapa duhet të ndërmerren në mënyrë që të çregjistrohet Sistemi Matës;
2. Cilat të dhëna duhet të shkëmbehen në mënyrë që të çregjistrohet sistemit matës.

Tabela vijuese paraqet një përmbledhje të shkurtë për planin kohor përkatësisht dokumentet input dhe output për regjistrimin e një Sistemi Matës.

Veprimet/Dokumentet	Pala Aplikuese D-Dërgon P-Pranon	OT D-Dërgon P-Pranon	OS D-Dërgon P=Pranon	Plani kohor Së paku X ditë pune para datës Efektive
Dorëzimi i formës së Çregjistrimit të plotësuar si duhet	D	P		30
Kontrollon formën e Çregjistrimit dhe njofton Operatorin e Sistemit		D	P	25
Dorëzon listën kontrolluese për çregjistrimin e Sistemit Matës (detalet teknike) ²	P		D	20
Kontrolli i vlefshmërisë së listës kontrolluese të Çregjistrimit: Miraton listën kontrolluese për çregjistrim ose Refuzon aplikimin për arsye të listës kontrolluese të pakompletuar (> > Prapa te “Dorëzoj si duhet formën e çregjistrimit)	P	P	D	15
Konfirmimi i çregjistrimit të suksesshëm	P	D	P	1; 12 am
De-aktivizimi / De-Energjizimi i	D	P	P	D+1, 5-10 am

² Për Sistemet e Matjes të Ndërlidhura psh. njehsorët e instaluar në Njësitë Gjeneruese të Ndërlidhura, Lista Kontrolluese për Regjistrimin e Sistemeve Matëse do t'i dërgohet Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes.


	Regjistrimi dhe Çregjistrimi i Sistemit Matës	PR-MO-003
	ver. 1.0	page 8 from 23
Departamenti: Operimi i tregut		Sektori: Menaxhimi i Kodit

Veprimet/Dokumentet	Pala Aplikuese D-Dërgon P-Pranon	OT D-Dërgon P-Pranon	OS D-Dërgon P=Pranon	Plani kohor Së paku X ditë pune para datës Efektive
Sistemit Matës				
Publikimi i Çregjistrimit të Sistemit Matës në Faqen Elektronike të KOSTT		D		D+1

4.4 Çregjistrimi i Sistemeve Matëse pas Anulimit të një Pjesëmarrësi të Tregut

Tabela vijuese ofron një përmbledhje të shkurtë për planin kohor përkatësisht dokumentet input dhe output për çregjistrimin e Sistemeve Matëse në pajtim me anulimin e një Pjesëmarrësit të Tregut sipas Procedurës Operative ET001.

Veprimet/Dokumentet	Pala Aplikuese D-Dërgon P-Pranon	OT D-Dërgon P-Pranon	OS D-Dërgon P-Pranon	Plani kohor Së paku X ditë pune para datës Efektive
Dorëzimi i Njoftimit për Anulim		D	P	10
Dërgoj listën kontrolluese për çregjistrim të plotësuar si duhet		P	D	5
Konfirmim çregjistrimit	P	D	P	4
De-Aktivizimi/De-Energjizimi i Sistemit Matës	P	P	D	D+1, 5-10 am
Konfirmimi i çregjistrimit të suksesshëm	P	D	P	D+1; 12 am
Publikimi i Çregjistrimit të Sistemit Matës		D		D+1

	Regjistrimi dhe Çregjistrimi i Sistemit Matës	PR-MO-003
	<i>ver. 1.0</i>	<i>page 9 from 23</i>
<i>Departamenti: Operimi i tregut</i>		<i>Sektori: Menaxhimi i Kodit</i>


4.5 Ndryshimi i të dhënave Teknike dhe Ndryshimi i të dhënave të Furnizuesit për Sistemet Matëse të Regjistruara

Ndryshimet e të dhënave teknike për Sistemet Matëse tashmë të regjistruara, kur një Sistem Matës zëvendësohet pjesërisht ose tërësisht.

Ndryshimet e të dhënave të furnizuesit të ndërlidhura me një sistem Matës tashmë të regjistruar bëhen të nevojshme nëse një konsumator i kualifikuar ka ndryshuar furnizuesin e vet.

Për shkak të ngjashmërisë së hapave të procesit ne po paraqesim të dy proceset në tabelën vijuese. Sidoqoftë, ata përshkruhen ndaras në kapitullin 0 dhe 0.

Veprimet/Dokumentet	Pala Aplikuese D- Dërgon P-Pranon	OT D- Dërgon P-Pranon	OS D- Dërgon P-Pranon	Plani kohor Së paku X ditë pune para datës Efektive
Dorëzon njoftimin për ndryshimet e kërkuara përfshirë autorizimet e nevojshme	D	P	(P për teknike)	20
Kontrollon njoftimin dhe nëse është e nevojshme kërkon informata shtesë		D		10
Përgjigjet në kërkesat e mundshme të OT	D	R		
Njofton OST dhe Pjesëmarrësin e Tregut për ndryshimin e suksesshëm të të Dhënave	P	D	P	1; 12 am

	Regjistrimi dhe Çregjistrimi i Sistemit Matës	PR-MO-003
	ver. 1.0	page 10 from 23
Departamenti: Operimi i tregut		Sektori: Menaxhimi i Kodit

5. PËRMBLEDHJA E PROCEDURËS

5.1 Dispozitat e Përgjithshme

Të gjitha pikat vijuese janë definuar si Pika Matëse dhe duhet të ofrohen ndaras me pajisjet matëse për:

- Secilën Pikë të Kyçjes të një Përdoruesi të Sistemit;
- Secila Pikë e Kyçjes ku Rrjeti i Shpërndarjes është i lidhur në Rrjetin e Shpërndarjes tjetër ose në Rrjetin e OST (KOSTT); dhe
- Secilën Pikë të Kyçjes ky Rrjeti i Transmisionit të Kosovës është i lidhur me rrjetin e një shteti tjetër.
- Secila Pikë e Kyçjes të Gjeneratorëve të lidhur në Rrjetin e Shpërndarjes.

Rregullat dhe kushtet teknike të aplikueshme për pajisjet matëse dhe sistemet informative koresponduese për leximin, procesimin, transmetimin dhe ruajtjen e vlerave të matjeve, si dhe për instalimin e pajisjeve matëse, pronën, mirëmbajtjen dhe leximin janë përcaktuar me Kodin e Matjes seksionet 8 dhe 9.

Të gjitha pikat vijuese janë definuar si Pika Matëse dhe duhet të ofrohen ndaras me pajisjet e matjes sipas dispozitave të Kodit të Matjes, seksioni 8.1.


- a) secila Pikë e Kyçjes së një Përdoruesi të Sistemit;
- b) secila Pikë e Kyçjes ku Rrjeti i Shpërndarjes është i lidhur me Rrjetin e Shpërndarjes tjetër ose me Rrjetin e OST (KOSTT); dhe
- c) secila Pikë Interkonektive.
- d) secila Pikë e Kyçjes së gjeneratorëve të lidhur me Rrjetin Shpërndarjes.

Të gjitha Pikat Matëse do të pajisen me Njehsor të cilët përmbushin së paku kërkesat minimale teknike, të dizajnit dhe operimit të specifikuara në Kodin e Matjes.

OT është përgjegjës për themelimin e formatit të kodit për Pikat e Matjes, dhe sipas rregullave të ETSO do të caktoj një kod unik identifikues për secilën Pikë të Matjes (referohu aneksit 6.3).

Kur një njehsor nga një Pikë e Matjes nuk i përmbush kërkesat e këtij seksioni Sektori i Matjes i OS, ose ndonjë palët tjetër përgjegjëse, do të jenë të obliguar të instalojnë njehsor të cilët janë në pajtueshmëri të plotë me kërkesat e Kodit të Matjes, Seksioni 8 dhe 9, të kushtëzuara me dispozitat e seksionit 7 të Kodit të Matjes.

Kur një njehsor instalohet për njësitë gjeneruese, ky OSSh, në Rrjetin e Shpërndarjes të të cilët është e ndërlidhur njësia gjeneruese do të jetë përgjegjës për regjistrimin e njehsorëve sipas kësaj Procedure Operative. OSSh do t'i ofroj informata OT në përdorimin e procedurave të njëjta OS në domenin e përgjegjësive së tij.

	Regjistrimi dhe Çregjistrimi i Sistemit Matës	PR-MO-003
	ver. 1.0	page 11 from 23
Departamenti: Operimi i tregut		Sektori: Menaxhimi i Kodit

5.2 Regjistrimi Fillestar i Sistemeve Matëse më 1 korrik 2007

Për regjistrimin fillestar të të gjithë Sistemeve Matëse në përdorim me 1 korrik 2007 OT do të dërgoj formën e regjistrimit (referohu aneksit 6.1) Pjesëmarrësve të Tregut si në vijim:

- (a) KEK Gjenerimi
- (b) KEK Shpërndarja
- (d) Të gjithë prodhuesit e pavarur³
- (e) Të gjithë konsumatorët e kualifikuar⁴
- (f) OST

Jo më vonë se 1 tetor 2007

Të gjithë Pjesëmarrësit e Tregut duhet të plotësojnë si duhet të dy format për të gjitha Sistemet Matëse të kërkuara nga OS deri më 10 tetor 2007.

OST duhet të regjistroj të gjitha Sistemet Matëse në Bazën e të Dhënave për Regjistrimin e Njehsorëve fillestar deri me 20 tetor 2007 dhe duhet të dërgojnë informatat e regjistrimit Pjesëmarrësve të Tregut.

OS jo më vonë se 10 dhjetor 2007 do të njoftoj OT se cilat Sisteme Matëse janë regjistruar në mënyrë që të detyroj OT t'i publikoj deri në fund të vitit 2007.

- Datën e Regjistrimit të Njehsorit

- DI të Pikës Matëse sipas Skemës Identifikuese të ETSO (referohu Aneksit 6.3).

OT do të përgatisë dhe mirëmbaj një bazë të të dhënave për sistemin matës, e cila përmban të dhënat e regjistrimit të pranuar dhe të konfirmuara nga të gjitha palët në O.

OST do të përgatis një skemë njëpolëshe për të gjithë njehsorët e regjistruar.


5.3 Regjistrimi i Sistemeve Matëse

Cilado Palë e cila dëshiron të regjistroj një Sistem Matës duhet t'i dorëzoj Operatorit të Rrjetit përkatës (OSSh ose OST) me shkrim dhe duhet të ofroj:

- (a) formën e regjistrimit të kompletuar si duhet (referohu aneksit 6.1), me detajet kontaktuese dhe informatat e nevojshme për Sistemin Matës
- (b) ofroj protokollin e testit i cili dëshmon testimin e saktë të Sistemit Matës, ose
- (c) në rast të Sistemit Matës të përdorur në kushte tranzicionale, dokumentet teknike të cilat dëshmojnë se Sistemi Matës përmbush kërkesat minimale teknike të definuara në Kodin e Matjes.

³ Kjo kërkesë i referohet të gjithë gjeneratorëve të pavarur pavarësisht se a janë instaluar njehsorët matës në nivelin e Rrjetit të Shpërndarjes apo Transmisionit.

⁴ Kjo kërkesë i referohet të gjithë konsumatorëve të kualifikuar pavarësisht se a janë instaluar njehsorët matës në nivelin e Rrjetit të Shpërndarjes apo Transmisionit.

	Regjistrimi dhe Çregjistrimi i Sistemit Matës	PR-MO-003
	ver. 1.0	page 12 from 23
Departamenti: Operimi i tregut		Sektori: Menaxhimi i Kodit

Pala aplikuese do të dorëzoj OT jo më vonë se 40 Ditë Pune para datës Efektive Formën e Regjistrimit të Sistemit Matës të plotësuar si duhet dhe të nënshkruar nga një person i autorizuar sipas 0.

Brenda 5 Ditëve të Punës nga pranimi i Formës së Regjistrimit të Sistemit Matës por jo më vonë se 35 Ditë Pune para Datës Efektive OT kontrollojnë se:

- 1. Pala është e regjistruar si Palë e Tregut në rolin në të cilin Pala dëshiron të regjistroj një Sistem Matës
- 2. Forma është autorizuar nga një person i autorizuar sipas 0.
- 3. Data Efektive për Sistemin Matës është në ose më vonë se Data Efektive për Regjistrimin e Pjesëmarrësve.

Nëse nuk janë plotësuar të gjitha kushtet OT do të refuzoj aplikimin për regjistrimin e Sistemit Matës me njoftim të menjëhershëm për palën aplikuese.

Kur OT të ketë kontrolluar se Forma e Regjistrimit të Sistemit Matës është plotësuar si duhet, dhe se janë ofruar të gjitha informatat dhe autorizimet e nevojshme OT do të njoftoj

- Palën aplikuese për regjistrimin e sistemit matës
- OS (sipas nevojës)

Për regjistrimin e paramenduar të Sistemit Matës jo më vonë se 25 Ditë Pune para datës Efektive

Ku një Sistem Matës është i ndërlidhur brenda një Sistemi Shpërndarës OT do të njoftoj OSSh për regjistrimin jo më vonë se 25 Ditë Puna para datës Efektive.

25 Ditë Pune para Datës Efektive Pala aplikuese për regjistrimin e Sistemit Matës do të dërgoj për vlerësim OS një listë kontrolluese të plotësuar si duhet.

20 Ditë Pune para Datës Efektive OS do të njoftoj Palën aplikuese për regjistrimin e Sistemit Matës dhe OT për vlerësimin e tij (nëse aplikacioni është refuzuar atëherë procedura fillon nga e para).


10 Ditë Pune nga Data Efektive Operatori i Sistemit Matës duhet të dëshmoj se testet kualifikuese të sistemeve të lidhjeve elektronike të të dhënave (për aq sa është e aplikueshme) për Sistemin Matës janë kaluar me sukses.

5 Ditë para Datës Efektive OS do të konfirmoj nëse Sistemi Matës testimi i dëshmisë është kryer me sukses. Ndërmjet orës 05:00 dhe 10:00 në D-2 para Datës Efektive OT do të njoftoj Palën operuese të Sistemit Matës dhe OS.

Jo më vonë se në ora 12:00 para Efektive prej ditës OS do të konfirmoj aktivizimin e suksesshëm të Sistemit Matës.

Në ditën D+1 OT do të publikoj të dhënat vijuese në faqen e vet: elektronike

- Identifikimin e Pikës Matëse (Kodi Identifikues i ETSO)
- Datën e Regjistrimit të Njehsorit.

	Regjistrimi dhe Çregjistrimi i Sistemit Matës	PR-MO-003
	ver. 1.0	page 13 from 23
Departamenti: Operimi i tregut		Sektori: Menaxhimi i Kodit

5.4 Çregjistrimi i Sistemeve Matëse

Së paku 30 Ditë Pune para Daës Efektive Pala e cila është operator i Sistemit Matës duhet të dorëzoj formën e çregjistrimit OT (referohu 0) të nënshkruar nga një person i autorizuar sipas 6.1

Brenda 5 Ditë Pune por së paku 25 ditë puna para datës efektive OT duhet të kontrolloj formën e çregjistrimit dhe njoftoj OS dhe Palën.

OS do të dërgoj listën kontrolluese të çregjistrimit Palës aplikuese 25 Ditë Pune para datës efektive.

Së paku 20 Ditë Pune Pala aplikuese duhet të dorëzoj OS formën e Çregjistrimit të plotësuar si duhet.

OS do të vlerësoj listën kontrolluese të çregjistrimit së paku 15 Ditë Pune para datës efektive dhe njoftoj OT dhe Palën (nëse refuzohet pala duhet të kthehet prapa te lista kontrolluese).


Në të njëjtën kohë sikur 0 kur Sistemi Matës është i ndërlidhur me një Sistem Shpërndarës OS do të informoj OSSh për çregjistrimin.

Sistemi Matës do të de-aktivizohet ndërmjet orës 05:00 dhe 10:00 në ditën pas datës Efektive.

Jo më vonë se ora 12:00 në ditën pas datës efektive OT do të çregjistroj Sistemin Matës nga baza e të dhënave të Regjistrimit të Matjes dhe do të konfirmoj Pjesëmarrësit e Tregut dhe OS çregjistrimin e suksesshëm të Sistemit Matës.

Pas 0, OT do të publikoj të dhënat vijuese në faqen e vet elektronike:

- Identifikimin e Pikës Matëse (Kodi Identifikues i ETSO)
- Datën e Çregjistrimit të Njehsorit.

	Regjistrimi dhe Çregjistrimi i Sistemit Matës	PR-MO-003
	ver. 1.0	page 14 from 23
Departamenti: Operimi i tregut		Sektori: Menaxhimi i Kodit

5.5 Çregjistrimi i Sistemeve të Matjes pas Anulimit të një Pjesëmarrësi të Tregut

OT do të njoftoj OS për anulimin e paramenduar të një Pjesëmarrësit të Tregut 10 Ditë Pune para datës efektive dhe rrjedhimisht do të kërkoj çregjistrimin e të gjitha Sistemeve Matëse të kësaj Pale.

Pas pranimit të autorizimit të çregjistrimit nga OT por 5 Ditë Pune para datës efektive OS do të kompletoj listën kontrolluese të çregjistrimit për të konfirmuar të gjithë hapat në procesin e çregjistrimit të Sistemit Matës për palën e cila do të anulohet.

Lista kontrolluese e çregjistrimit duhet të plotësohet dhe t'i dorëzohet OT brenda 5 Ditë Pune para datës efektive.


Menjëherë pas pranimit të listës kontrolluese të çregjistrimit plotësuar si duhet por jo më vonë se 4 Ditë Pune para datës efektive OT do të konfirmoj datën e de-aktivizimit.

Sistemi Matës do të de-aktivizohet/de-energizohet ndërmjet orës 05:00 dhe 10:00 në ditën pas datës efektive.

OT do të çregjistroj Sistemin Matës nga Baza e të Dhënave të Matjes jo më vonë se ora 12:00 në ditën pas datës efektive dhe do t'i konfirmoj Pjesëmarrësit të Tregut dhe OS çregjistrimin e suksesshëm të Sistemit Matës.

Pas 0, OT do të publikoj të dhënat vijuese në faqen e vet elektronike:

- Identifikimin e Pikës Matëse (Kodi Identifikues i ETSO)
- Datën e Çregjistrimit të Njehsorit.

	Regjistrimi dhe Çregjistrimi i Sistemit Matës	PR-MO-003
	ver. 1.0	page 15 from 23
Departamenti: Operimi i tregut		Sektori: Menaxhimi i Kodit

5.6 Ndryshimi i të Dhënave Teknike të Sistemeve Matëse të Regjistruara

Nëse, përveç në rast ku një defekt ndikon në cilëndo pjesë të pajisjeve e cila formon një sistem matës, në çfarëdo kohe një Palë dëshiron të ndryshoj të dhënat e regjistrimit të parametrave teknike ose çfarëdo detaji tjetër për Sistemet Matëse dhe/ose ka ndryshime në të dhënat e regjistrimit të Sistemeve Matëse Pala e tillë duhet të njoftoj OT sa më parë që është arsyeshëm praktike por jo më vonë se 20 Ditë Pune para datës efektive, dhe kurdoherë që është e mundur para ndryshimit të tillë dhe duhet të ofroj informata dhe dokumentacion mbështetës si mund të kërkohej arsyeshëm nga OT për të evidentuar ndryshimin e tillë (referohu aneksit 6.1 dhe 6.2.)

Çfarëdo ndryshimi në detajet teknike të Sistemeve Matëse të cilat janë të shkaktuara nga zëvendësimi i matjes së dështuar janë të vlefshme nga data e zëvendësimit.

Ndryshimet e pjesëve të pajisjeve me të njëjtin specifikim nuk konsiderohen si ndryshim i të dhënave teknike sipas 0.

Me pranimin e një njoftimi sipas paragrafit 0 OT do të përmirësoj të Dhënat e Regjistrimit të mirëmbajtura në Regjistrin e Sistemit Matës për të reflektuar çfarëdo ndryshimi të pasqyruar në një aplikacion të tillë.

Në rast të mospërputhjeve të të dhënave ose parametrave teknike për tu ndryshuar, OT menjëherë do të kontaktoj palën aplikuese por jo më vonë se 10 Ditë Pune para datës efektive.

Pala aplikuese për ndryshime duhet t'i përgjigjet menjëherë cilëndo pyetje ose kërkesë për informata në detaje nga OT.

Në rast se ndryshimet në të dhënat e regjistrimit të Sistemit Matës janë shkaktuar nga ndryshimi i rolit të tregut ose përgjegjësisë e palës aplikuese, seksioni 5 i procedurës operative ET001 gjithashtu duhet të merret në konsideratë.

OT do t'i konfirmoj Pjesëmarrësit të Tregut dhe OS ndryshimin e suksesshëm të të dhënave teknike të Sistemit Matës jo më vonë se ora 12:00 në D-1 para datës efektive.

	Regjistrimi dhe Çregjistrimi i Sistemit Matës	PR-MO-003
	ver. 1.0	page 16 from 23
Departamenti: Operimi i tregut		Sektori: Menaxhimi i Kodit

5.7 Ndryshimi i të Dhënave të Furnizuesit të Sistemeve Matëse të Regjistruara (ndërrimi i konsumatorit)

Nëse një konsumator i kualifikuar sipas procesit për ndërrimin e konsumatorit ka ndryshuar furnizuesin, Pala (duke qenë Furnizuesi i ri) duhet të dërgoj njoftimin me shkrim OT sa më parë që është arsyeshëm praktike por jo më vonë se 20 Ditë Pune para datës efektive, dhe kurdoherë që është e mundur para ndryshimit të tillë dhe duhet të ofroj informata shtesë dhe dokumentacion mbështetës si mund ta OT kërkoj arsyeshëm për të evidentuar ndryshimin e tillë.


Me pranimin e një njoftimi sipas paragrafit 0 OT do të përmirësoj të Dhënat e Regjistrimit të mirëmbajtura në Regjistrin e Sistemit Matës për të reflektuar ndryshimet e përcaktuara në aplikimin e tillë.

Në rast të ndonjë mos përputhje të të dhënave që do të ndryshohen OT menjëherë do të kontaktoj palën aplikuese, por jo më vonë se 10 Ditë Pune para datës efektive.

Pala e cila aplikon për ndryshime duhet që menjëherë t'i përgjigjet çfarëdo pyetje dhe kërkesë nga OT për informata detale.

Në rast të ndryshimeve në të dhënat e regjistrimit të Sistemit Matës janë shkaktuar nga ndonjë ndryshim në rolin e tregut ose përgjegjësisë së palës aplikuese, seksioni 5 i procedurës operative ET001 duhet gjithashtu të konsiderohet.

OT do t'i konfirmoj Pjesëmarrësit të Tregut dhe OS ndryshimin e suksesshëm të të dhënave teknike të Sistemit Matës jo më vonë se ora 12:00 në D-1 para datës efektive.

	Regjistrimi dhe Çregjistrimi i Sistemit Matës	PR-MO-003
	ver. 1.0	page 17 from 23
Departamenti: Operimi i tregut		Sektori: Menaxhimi i Kodit

6 . ANEKSET

Aneksi 1: Forma e Regjistrimit dhe Çregjistrimit të Sistemit Matës (ju lutem shihni faqen vijuese për një shembull)

Forma e Regjistrimit/Çregjistrimit të Sistemit Matës

(Përfshirë Zgjerimin ose Ndryshimin e Sistemeve Matëse)

Për: KOSTT		Data e dërgimit _____
Nga Pala Tregtare		
DI e Palës Tregtare _____	Emri i dërguesit _____	
E-mail adresa kontaktuese _____		
Referenca jonë _____	Nr. Tel Kontaktues _____	

1. Detajet e Regjistrimit

Emri i të regjistruarit

Konfirmoj se në ora..... me .../.../.... Sistemit Matës i nevojitur për qëllim të Rregullave të Tregut do të

- Instalohet tërësisht, komisionohet dhe operohet në lokacionin e paraqitur më poshtë
- De-instalohet
- Ndryshohet si pjesë e punës rindërtuese

2. Lokacioni i sistemit matës

Referenca e rrjetit (nëse aplikohet)	GPS referenca (nëse aplikohet)
Qarku	Kodi EIC i Pikës Matëse (nëse aplikohet)

Emri i lokacionit _____

Adresa e lokacionit _____

Me këtë ne deklarojmë (Emri i Palës Tregtare) se ne do të marrim përgjegjësinë për barazimin e energjisë së matur në Pikën Matëse të përmendur në (2).

Nënshkruar për të regjistruarin

	Data _____
Emri i nënshkruesit të autorizuar _____	
Nënshkrimi i autorizuar _____	Fjalëkalimi _____



Metering System Registration/De-Registration form
(Including Extension or Modification to Metering Systems)

To: KOSTT	Date Sent:
From: Market Party	
Market Party ID:	Name of Sender:
Contact email address:	
Our Ref:	Contact Tel. No.

1. Details of Registrant

Name of Registrant:

I confirm that as at hours on/...../..... the Metering System required for the purposes of the Market Rules will be


- fully installed, commissioned and operational at the site detailed below
- de-installed
- Changed as part of reconstruction work

2. Location of Metering System

Grid Reference: (if applicable)	GSP reference: (if applicable)
Circuit(s)	Metering Point EIC Code (if applicable)
Site Name:	
Site Address:	
.....	

Hereby, we declare that [Market Party Name] that we will take the responsibility for settlement of the energy measured on the Metering Point mentioned in (2).

Signed for Registrant
.....	Date:
Name of Authorised Signatory:	
Authorised Signature:	Password:

	Regjistrimi dhe Çregjistrimi i Sistemit Matës	PR-MO-003
	ver. 1.0	page 19 from 23
Departamenti: Operimi i tregut		Sektori: Menaxhimi i Kodit

Aneksi 2: Lista Kontrolluese për Regjistrimin e Sistemit Matës dhe Struktura e MS Bazës së të Dhënave

Ju lutem shihni më poshtë një shembull për kolonat e kërkuara për listën kontrolluese të regjistrimit dhe struktura përkatëse e tabelës së bazës së të dhënave të Sistemit Matës.

Tabela 1:

DI e Operatorit të Njehsorit EIC Kodi
DI e Pikës Matëse [EIC Kodi, të definohet nga KOSTT]
Emri i qarkut
Numri i njehsorit
Pozita (kjo duhet të përfshijë skemën njëpolëshe të qarqeve primare dhe sekondare)
Faktori i përmirësimit të humbjeve
Drejtimi
Niveli i tensionit
Klasa e saktësisë së njehsorit
Numri Serik i Njehsorit
Numri Serik i Pllombës së Prodhuesit së Njehsorit
MTI Numri Serik i Njehsorit ose Shenja
Numri Serik i Pllombës së OST
Kodi i TRr
Kodi TT
Njehsori kontrollues
Ndonjë Derogim i Njehsorit

Tabela 2: Detalet e Palës

DI e Pikës Matëse (EIC Kodi)
DI e Palës Tregtare EIC Kodi (DI e Furnizuesit)
Emri kontaktues
Adresa kontaktuese
E-Mail
Nr. Tel



	Regjistrimi dhe Çregjistrimi i Sistemit Matës	PR-MO-003
	ver. 1.0	page 20 from 23
Departamenti: Operimi i tregut		Sektori: Menaxhimi i Kodit

Tabela 3: Detajet TT


Kodi i TT
Tipi
Shkalla e lidhjes
Vjetërsia ose data e prodhimit
Prodhuesi
Klasa e saktësisë
Shkalla e ngarkesës
Numri serik i OST për pajisjen e TT Faza R
Numri serik i OST për pajisjen e TT Faza S
Numri serik i OST për pajisjen e TT Faza T
Numri serik i pllombës së OST për TT Faza R
Numri serik i pllombës së OST për TT Faza S
Numri serik i pllombës së OST për TT Faza T
Kutia Nr. 1 e lidhjes së qarkut të TT të OST Numri serik i pllombës
Kutia Nr. 2 e lidhjes së qarkut të TT të OST Numri serik i pllombës
Kutia Nr. 3 e lidhjes së qarkut të TT të OST Numri serik i pllombës
Përdorimi i përbashkët (njehsori kontrollues, mbrojtja)
Ndonjë derogim

Tabela 4: Detalet e TRr

Kodi i TRr
Tipi
Shkalla e lidhjes
Vjetërsia ose data e prodhimit
Prodhuesi
Klasa e saktësisë
Shkalla e ngarkesës
Numri serik i OST për pajisjen e TRr Faza R
Numri serik i OST për pajisjen e TRr Faza S
Numri serik i OST për pajisjen e TRr Faza T
Numri serik i pllombës së OST për TRr Faza R
Numri serik i pllombës së OST për TRr Faza S
Numri serik i pllombës së OST për TRr Faza T
Kutia Nr. 1 e lidhjes së qarkut të TRr të OST Numri serik i pllombës
Kutia Nr. 2 e lidhjes së qarkut të TRr të OST Numri serik i pllombës

	Regjistrimi dhe Çregjistrimi i Sistemit Matës	PR-MO-003
	<i>ver. 1.0</i>	<i>page 21 from 23</i>
<i>Departamenti: Operimi i tregut</i>		<i>Sektori: Menaxhimi i Kodit</i>

Kutia Nr. 3 e lidhjes së qarkut të TRr të OST Numri serik i pllombës
Përdorimi i përbashkët (njehsori kontrollues, mbrojtja)
Ndonjë derogim

	Regjistrimi dhe Çregjistrimi i Sistemit Matës	PR-MO-003
	ver. 1.0	page 22 from 23
Departamenti: Operimi i tregut	Sektori: Menaxhimi i Kodit	

Aneksi 3: Skema e ETSO për Identifikimin e Pikës Matëse

Fotografia vijuese jep një përmbledhje. Kërkesat për dizajnin e EIC Kodeve për Pikat Matëse janë në dispozicion në www.edi.etso-net.org >> referohu Skema e Kodifikimit Identifikues Energjetik (Energy Identification Coding Scheme)

KIE (Skema e Kodifikimit Identifikues Energjetik) – (2)

Zyra lëshuese emri numri kontrollues

Për orar

“w” = njësia, objekti


“x” = pala e tregut


“y” = zona

“z” = pika matëse (vetëm për përdorim të OST)

Emri i shfaqur psh. RWE Transportnetz

Emri i shfaqur është i dobishëm nëse përdorën EIC Kodet “jo të rëndësishme”



	Regjistrimi dhe Çregjistrimi i Sistemit Matës	PR-MO-003
	<i>ver. 1.0</i>	<i>page 23 from 23</i>
<i>Departamenti: Operimi i tregut</i>		<i>Sektori: Menaxhimi i Kodit</i>

7. DOKUMENTET/FORMULARËT

Burimet

Nr.	Emri i dokumentit
1	Rregullat e Tregut
2	Kodi i Matjeve

Dokumentet/formularët

- Forma e regjistrimit dhe çregjistrimit

Shënimet për versionet

Versioni	Data	Përshkrimi	Kohëruajtja
1.0	Janar 2008	Verzioni inicial	5 vite